

UDHËZIM¹
MBI FORMËN E NJOFTIMIT TË PËRQËNDRIMIT

***Në zbatim të Ligjit nr. 9121, Datë 28.7.2003 “për mbrojtjen e konkurrencës”
dhe rregullores “për zbatimin e procedurave të kontrollit të përqendrimit të
ndërmarrjeve”,***

KOMISIONI I KONKURENCËS

VENDOSI:

1. Qëllimi i udhëzimit

Ky udhëzim sqaron mënyrën dhe llojin e informacionit që duhet siguruar nga pala njoftuese, në rast të njoftimit të një përqendrimi, për marrje autorizimi nga Komisioni i Konkurrencës.

Një përqendrim i përcaktuar në nenin 10 të ligjit nr. 9121 “Për Mbrojtjen e Konkurrencës” (këtu e në vijim “Ligji”), nëse plotëson, në mënyrë kumulative, kushtin e kufirit të xhiros të përcaktuar në nenin 12, pika 1, shkronjat a) dhe b) të Ligjit, njoftohet në Autoritet, nga palët pjesëmarrëse në përqendrim.

2. Kush duhet të njoftojë?

Në rastet e përqendrimeve, në kuptim të nenit 10 të Ligjit, detyrimin për njoftim e kanë:

- Në rastin e bashkimit apo përfutimit të kontrollit, blerësi apo përfutuesi i kontrollit ose përfaqësuesi/t ligjorë me prokurë;
- Në rastin e krijimit të një ndërmarrje të përbashkët, pjesëmarrësit në krijimin e ndërmarrjes së përbashkët;
- Në rastin e publikimit të ofertës publike, ofertuesi ose përfaqësuesi/t ligjorë me prokurë.

Secila nga palët që bën njoftimin është përgjegjëse për saktësinë e informacionit të siguruar.

3. Kërkesa për një njoftim të saktë dhe të plotë

I gjithë informacioni i kërkuar në Formularin e Njoftimit bashkëlidhur këtij udhëzimi, (Forma e Plotë apo Forma e Thjeshtuar) duhet të jetë i saktë dhe i plotë. Informacioni i kërkuar duhet të jepet në Seksionin përkatës të Formularit.

¹ Miratuar me vendimin e Komisionit të Konkurrencës nr. 82 / Datë 23/06/ 2008

Veçanërisht duhet të bëni kujdes që:

- (a) zbatimi i afateve kohore të parashikuara në Ligji që kanë të bëjnë me njoftimin e përqendrimit dhe autorizimin nga ana e Komisionit.
- (b) Në rast se një njoftim është jo i plotë, Autoriteti në përputhje me nenin 54, do të njoftojë me shkrim pa vonesë palët njoftuese apo përfaqësuesit e tyre duke përcaktuar edhe afatin kohor për plotësimin e tij. Procedura e shqyrtimit të njoftimit të përqendrimit fillon në datën në të cilën do jepet nga Sekretariati i Autoritetit të Konkurrencës, konfirmimi që njoftimi është i plotë sipas nenit 11 të rregullores “për zbatimin e procedurave të përqendrimit të ndërmarrjeve”.
- (c) Palët njoftuese gjatë kohës së përgatitjes së njoftimit duhet të verifikojnë që emrat e personave të kontaktit dhe numrat e tel/fax, adresa e-mail të vendosura në formular të jenë të sakta, funksionale dhe të përditësuara pasi mund të jetë shkak për deklarimin e njoftimit të paplotë.
- (d) Sipas nenit 73 pika 1 (b) e ligjit informacioni jo plotë dhe mashtrues i dhënë me qëllim ose për arsye neglizhence, sjell si pasojë gjorbitjen e palëve njoftuese deri në 1% të xhiros totale të vitit paraardhës. Në bazë të nenit 46 shkronja (c) e ligjit Komisioni mund të revokojë vendimin e tij në lidhje me një përqendrim të njoftuar, kur ai rezulton të jetë dhënë mbi bazë të informacioneve jo të sakta, për të cilat njëra prej ndërmarrjet pjesëmarrëse në përqendrim është përgjegjëse.
- (e) Palët mund të kërkojnë nga Autoriteti një konfirmim me shkrim se njoftimi është i plotë, pavarësisht mos-sigurimit të ndonjë informacioni të kërkuar në Formular, kur ky informacion nuk është i disponueshëm plotësisht ose pjesërisht për shkaqe të arsyeshme dhe/ose ky informacion nuk është i nevojshëm në shqyrtimin e rastit konkret.
- (f) Sekretariati, pas vlerësimit të argumenteve të palës(ve) njoftuese mund ti pranojë ato dhe mund të përjashtojë palët nga detyrimi për dhënien e ndonjë informacioni të veçantë të kërkuar në Formular (Forma e Plotë apo e Forma e Thjeshtuar), përfshirë dokumente, atëherë kur mendon se një informacion i tillë nuk është i nevojshëm për shqyrtimin e çështjes.

4. Si bëhet njoftimi?

- a) Njoftimi duhet të plotësohet në gjuhën shqipe.
- b) Informacioni i kërkuar në këtë Formular duhet të parashtrohet në seksione dhe paragrafët përkatës të Formularit, duke nënshkruar një deklaratë sipas parashikimit në Seksionin 11. Formularit të njoftimit i bashkëngjitet edhe dokumentacioni shoqërues përkatës.
- c) Për transparencë, dokumentacioni mbështetës i informacionit vendoset në anekset bashkëlidhur Formularit. Megjithatë, është e rëndësishme që

- pjesët kryesore të informacionit, veçanërisht informacioni për pjesët e tregut për palët dhe konkurrentët e tyre më të mëdhenj të paraqiten në Formularin e Njoftimit.
- d) Dokumentet shoqëruese duhet të paraqiten në gjuhën shqipe. Nëse këto dokumente janë në gjuhë të huaj shoqërohet me një kopje të përkthyer dhe noterizuar në gjuhën shqipe.
 - e) Dokumentet shoqëruese duhet të jenë origjinale ose kopje të noterizuara.
 - f) Njoftimi paraqitet në adresën e mëposhtme:
Autoriteti i Konkurrencës
Rruga “Sami Frashri”, Nr 4, Kati IV
Tiranë - Shqipëri.
 - g) Palët mund të marrin udhëzuesin dhe formularët (i thjeshtuar ose i plotë) në faqen zyrtare të internetit të Autoritetit të Konkurrencës www.caa.gov.al, në rubrikën “Përqendrimet”.
 - h) Njoftimi mund të dorëzohet në Autoritetin e Konkurrencës çdo ditë, brenda orarit zyrtar i cili gjendet i publikuar në faqen zyrtare të internetit të Autoritetit të Konkurrencës.
 - i) Procedura e kontrollit të përqendrimeve bëhet kundrejt pagesës së parashikuar në rregulloren “Për përcaktimin e shpenzimeve për ndjekjen e procedurave pranë Autoritetit të Konkurrencës”, në llogarinë bankare të institucionit:
 - I. Fillimi i Procedurës bëhet kundrejt pagesës me vlerë 15.000 lekë.
 - II. Autorizimi “Për realizimin e përkohshëm të përqendrimit” bëhet kundrejt pagesës me vlerë 300.000 lekë.
 - III. Autorizimi “Për realizimin e përqendrimit” jepet kundrejt pagesës me vlerë 500.000 lekë.

5. Konfidencialiteti

Në përputhje me legjislacionin në fuqi, Rregulloren “Mbi Funksionimin e Autoritetit të Konkurrencës”, Kodin e Etikës, punonjësit e Autoritetit të Konkurrencës detyrohen të mos deklarojnë informacionin që ata e kanë përftuar gjatë kryerjes së detyrës së tyre profesionale dhe të ruajnë konfidencialitetin ndërmjet palëve njoftuese.

Nëse palët njoftuese mendojnë se interesat e tyre do të dëmtoheshin nëse një pjesë e informacionit që atyre u është kërkuar në Formularin e Njoftimit të paraqitur pranë Autoritetit të Konkurrencës, do të publikohej ose do t’u deklarohet palëve të tjera, ato duhet ta paraqesin këtë informacion të ndarë me secilën faqe qartësisht të shënuar “Sekrete të veprimtarisë ekonomike”, duke dhënë edhe arsyet se pse ky informacion nuk duhet të deklarohet ose publikohet.

6. Përkufizimet për qëllimet e këtij Formulari

Pala ose palët njoftuese: në rastet kur një njoftim paraqitet vetëm nga një prej ndërmarrjeve që është palë në përqendrim, “palët njoftuese” përdoret për t’iu referuar vetëm ndërmarrjes që faktikisht paraqet njoftimin.

Pala(ët) në përqendrim ose palët: këto terma kanë të bëjnë me palët përftuese dhe të përftuara, ose me palët që bashkohen, duke përfshirë të gjitha ndërmarrjet në të cilat po përftohet një interes kontrolli ose që i nënshtrohet një oferte publike.

Përveç kur përcaktohet ndryshe, termat **palë(t) njoftuese dhe palë(t)** në përqendrim, përfshijnë të gjitha ndërmarrjet që u takojnë të njëjtave grupe si ato palë.

Vit: të gjitha referencat tek fjala “vit” në këtë Formular, duhet të kuptohet si vit kalendarik, nëse nuk përcaktohet ndryshe. I gjithë informacioni i kërkuar në këtë Formular, nëse nuk përcaktohet ndryshe, duhet t’i takojë vitit që paraprin atë të njoftimit.

Të dhënat financiare të kërkuara në formularin e njoftimit të thjeshtë apo të plotë, duhet të jepen në Lek, me kursin zyrtar mesatar të këmbimit të vitit ose periudhave të tjera në fjalë publikuar nga Banka e Shqipërisë.

7. Kriteret që duhen përmbushur për përdorimin e Formularit të Thjeshtuar

Formulari i Thjeshtuar përcakton informacionin që duhet të jepet nga palët njoftuese kur njoftojnë një përqendrim pranë Autoritetit të Konkurrencës dhe kur ky përqendrim nuk shfaq probleme për konkurrencën në tregun përkatës.

Formulari i Thjeshtuar në bazë të nenit 9, pika 1 të Rregullores “Për zbatimin e procedurave të përqendrimit të ndërmarrjeve” plotësohet nga të gjitha palët njoftuese.

Sipas pikës 2 të nenit 9 të Rregullores, Sekretariati argumenton me shkrim nëse plotësohen kriteret e mëposhtme për formën e thjeshtuar, duke përjashtuar formularin e plotë:

- a) Në rastin e transaksioneve që sjellin një përqendrim, veprimtaria ekonomike e ndërmarrjes së dalë pas përqendrimit realizohet në një treg produkti dhe gjeografik lokal, brenda territorit të Shqipërisë;
- b) Palët pjesëmarrëse në përqendrim veprojnë në tregje të ndryshme përkatëse të produktit dhe atij gjeografik (nuk ka mbivendosje horizontale).
- c) Kur palët në përqendrim janë përfshirë në veprimtari ekonomike në të njëjtin nivel tregu përkatës të produktit dhe atij gjeografik (marrëdhënie horizontale), me kusht që pjesa e tyre e kombinuar e tregut në nivel horizontal është më pak se 15% ose pjesa e kombinuar e tregut në nivel vertikal nuk është më shumë se 25%;

- d) Një palë përfton kontroll të vetëm të një ndërmarrjeje mbi të cilën ajo ka pasur kontroll të përbashkët.

8. Njoftimi sipas Formularit të Plotë të Njoftimit

1. Autoriteti, kur gjen që kushtet për përdorimin e Formularit të Thjeshtuar nuk përmbushen, kërkon nga palët pjesëmarrëse në përqendrim, përdorimin e Formës së Plotë të Njoftimit.
2. Autoriteti, kur vlerëson se përqendrimi shkakton shqetësime për konkurrencën, pavarësisht se përmbushen kushtet për njoftimin në Formën e Thjeshtuar, vendos t'u kërkojë palëve njoftuese përdorimin e Formularit të Plotë të njoftimit.
3. Plotësimi i Formularit të Plotë të Njoftimit kërkohet edhe në rastin e një pale që përfton kontroll të vetëm të një ndërmarrjeje të përbashkët në të cilën ajo ka tashmë kontroll të përbashkët, nëse pala përftuese dhe ndërmarrja e përbashkët së bashku kanë një pozicion të fortë në treg, ose ndërmarrja e përbashkët dhe pala përftuese kanë pozicione të forta në tregjet e lidhura vertikalisht.

Shembuj të domosdoshmërisë të përdorimit të Formularit të Plotë të Njoftimit, janë ato raste të përqendrimeve, ku është e vështirë të përcaktohen tregjet përkatëse, për shembull:

- tregjet në zhvillim;
- kur një palë është një hyrës i ri ose potencial, ose një zotërues i rëndësishëm patente;
- kur nuk është e mundur të përcaktohen rregullisht pjesët e tregut të palëve;
- në tregjet me barriera të lartë hyrjeje,
- në tregje me një shkallë të lartë përqendrimi ose me probleme të njohura konkurrence;
- kur të paktën dy palë në përqendrim janë të pranishme në tregjet fqinjë ngushtësisht të lidhur; dhe
- në përqendrimet që mundësojnë koordinimin e sjelljes së ndërmarrjeve të treg.